

Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo

Qeveria
Vlada – Government
Zyra e Kryeministrit
Kancelarija Premijera - Office of the Prime Minister

REFERENCË:	32-2-2020
DATË:	26/08/2020
PËR/ZA/TO:	Ardian Bajraktari, Drejtor i Zyrës Ligjore / Ministria e Drejtësisë
CC:	Fitim Krasniqi, Sekretar i Përgjithshëm / Zyra e Kryeministrit
PËRMES/PREKO/THROUGH:	Florim Canolli, Drejtor i Departamentit të Asistencës Zhvillimore / Zyra e Kryeministrit
NGA/OD/FROM:	Novitet Nezaj, Drejtor i Departamentit për të Drejtën e BE-së/Zyra e Kryeministrit
TEMA/SUBJEKAT/SUBJECT:	Shkresa përcjellëse për lëshimin e opinionit ligjor të përputhshmërisë për "Projektligjin për Ratifikimin e Marrëveshjes Ndërmjet Qeverisë së Republikës së Kosovës dhe Republikës së Italisë për Transferimin e Personave të Dënuar"

I nderuari z Bajraktari,

Duke u bazuar në Udhëzimin Administrativ nr. 03/2013 për Standardet e Hartimit të Akteve Normative dhe Rregulloren nr. 13/2013 për Shërbimin Ligjor Qeveritar, ju përcjellim Opinionin Ligjor të Përputhshmërisë me *acquis* të BE-së për "Projektligjin për Ratifikimin e Marrëveshjes Ndërmjet Qeverisë së Republikës së Kosovës dhe Republikës së Italisë për Transferimin e Personave të Dënuar".

Me respekt!



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada – Government
Zyra e Kryeministrit
Kancelaria Premijera - Office of the Prime Minister

OPINIONI LIGJOR I PËRPUTHSHMËRISË ME LEGJISLACIONIN E BE-SË

26.08.2020

Departamenti Ligjor i Ministrisë së Drejtësisë me datë 26 gusht 2020, bazuar në nenin 7 nënparagrafin 1.2 të Rregullores Nr. 09/2011 të Punës së Qeverisë së Republikës së Kosovës dhe nenit 13 paragrafi 5 të Rregullores Nr. 13/2013 për Shërbimin Ligjor Qeveritar ka dorëzuar për shqyrtim në Departamentin e të Drejtës së BE-së “*Projektligjin për Ratifikimin e Marrëveshjes Ndërmjet Qeverisë së Republikës së Kosovës dhe Republikës së Italisë për Transferimin e Personave të Dënuar*”.

1. SUBJEKTI

Opinion ligjor për përputhshmërinë e “*Projektligjit për Ratifikimin e Marrëveshjes Ndërmjet Qeverisë së Republikës së Kosovës dhe Republikës së Italisë për Transferimin e Personave të Dënuar*” me *acquis* të BE-së.

2. DOKUMENTET E BASHKËNGJITURA

Në kërkesën e Ministrisë së Drejtësisë për opinion ligjor të përputhshmërisë me *acquis* të BE-së, janë dërguar këto dokumente:

- Drafti përfundimtar i “*Projektligjit për Ratifikimin e Marrëveshjes Ndërmjet Qeverisë së Republikës së Kosovës dhe Republikës së Italisë për Transferimin e Personave të Dënuar*” (*shqip, sërbisht, anglisht*);
- Deklarata e Përputhshmërisë së legjislacionit të Republikës së Kosovës me *acquis* të BE-së (*shqip, sërbisht, anglisht*);
- Memorandumi Shpjegues (*shqip, sërbisht, anglisht*);

3. PREAMBULA

Në pajtim me nenin 7 paragrafi 3 të Rregullores Nr. 09/2011 të Punës së Qeverisë së Republikës së Kosovës, në bazë të nenit 3 nënparagrafi 1.3, Neni 13 paragrafi 6, Neni 21 paragrafi 4 të Rregullores Nr. 13/2013 për Shërbimin Ligjor Qeveritar dhe nenit 30 paragrafi 4 të Udhëzimit Administrativ Nr. 03/2013 për Standardet e Hartimit të Akteve Normative, Departamenti i të Drejtës së BE-së, me 26 gusht 2020 lëshon këtë:

4. OPINION LIGJOR PËR PËRPUTHSHMËRINË ME LEGJISLACIONIN E BE-SË

Kërkesa për opinionin ligjor me *acquis* të BE-së është dërguar në kopje fizike dhe elektronike më datën 26 gusht 2020 me numër të referencës 32-1-2020.

5. HYRJE

Qëllimi i “*Projektligjit për Ratifikimin e Marrëveshjes Ndërmjet Qeverisë së Republikës së Kosovës dhe Republikës së Italisë për Transferimin e Personave të Dënuar*” është ratifikimi i Marrëveshjes

ndërmjet Qeverisë së Republikës së Kosovës dhe Qeverisë së Republikës së Italisë për Transferimin e Personave të Dënuar, të nënshkruar nga Ministrat e Drejtësisë të të dy vendeve, më 11 prill 2019, në Romë.¹ Ky projektligj i ka tre (3) nene.

6. PËRMBLEDHJA E AKTEVE TË BE-SË QË RREGULLOJNË FUSHËN E PROJEKT AKTIT

Në kuadër të BE-së, fushëveprimi i projekt-aktit në fjalë nuk është i rregulluar specifikisht me legjislacion të BE-së. Rrjedhimisht, kjo fushë e veprimtarisë mbetet në kompetencë të brendshme të shteteve anëtare të BE-së.

7. PËRSHKRIMI DHE VLERËSIMI I DOKUMENTEVE TË DËRGUARA ME LEGJISLACIONIN E PROPOZUAR NGA MINISTRIA E LINJËS

I. Në aspektin përmbajtësor dhe ligjor,

Duke ju referuar pikës 6 të këtij Opinioni Ligjor, dispozitat e “Projektligjit për Ratifikimin e Marrëveshjes Ndërmjet Qeverisë së Republikës së Kosovës dhe Republikës së Italisë për Transferimin e Personave të Dënuar”, nuk rregullohen në nivel të BE-së dhe si rrjedhojë ky projekt ligj nuk transponon ndonjë akt të së drejtës së BE-së.

II. Në aspektin teknik,

Të gjitha dokumentet e tjera janë dërguar dhe plotësuar sipas manualit për plotësimin e tabelave të përputhshmërisë dhe deklaratës së përputhshmërisë.


8. OPINIONI PËR PËRPUTHSHMËRINË

Ky opinion për përputhshmërinë me *acquis* është bazuar në përmbajtjen e projektligjit. Përgjegjësia e Departamentit të së Drejtës së BE-së, vihet në dukje me opinionin e saj, ndërsa organi propozues, është përgjegjës të plotësojë Deklaratën e Përputhshmërisë (DeP) dhe Tabelat e Përputhshmërisë (TeP) atëherë kur Projekt-akti ndërlidhet me transpozim të *acquis* së BE-së. Institucionet e linjës janë përgjegjëse për politikën që ato bëjnë dhe për shkallën e harmonizimit me *acquis* të BE-së. Prandaj, periudhat paraprake nga transpozimi i pjesërishtë deri në transpozim të plotë janë përgjegjësi e organit propozues të projektligjit. Paraprakisht, plotësimi dhe përcaktimi i nivelit të përputhshmërisë me *acquis* të BE-së, është përgjegjësi e institucioneve të linjës.²

9. VLERËSIMI I PËRPUTHSHMËRISË

Dispozitat e “Projektligjit për Ratifikimin e Marrëveshjes Ndërmjet Qeverisë së Republikës së Kosovës dhe Republikës së Italisë për Transferimin e Personave të Dënuar” nuk janë të rregulluara me legjislacion të BE-së dhe si e tillë kjo fushë e veprimtarisë mbetet në kompetencë të brendshme të shteteve anëtare të BE-së.

Me respekt,



Urim Salihu
Zyrtar i Lartë Ligjor
Departamenti i së Drejtës së BE-së
Zyra e Kryeministrit

¹ Neni 1 i “Projektligjit për Ratifikimin e Marrëveshjes Ndërmjet Qeverisë së Republikës së Kosovës dhe Republikës së Italisë për Transferimin e Personave të Dënuar”.

² E qasshme në: <http://www.mei-ks.net/sq/dokumente-udhezuese-mbi-procesin-e-perafimit>